



FEDERATA E NOTIT E KOSOVES
KOSOVO SWIMMING FEDERATION


Nr. Protokolit 02/2023
Dt. 07 | 01 | 2023
Prishtinë

RREGULLORE
MBI PËRFAQËSUESEN E NOTIT TË KOSOVËS

Prishtinë
Janar 2023

Bordi Ekzekutiv i Federatës së Notit të Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 12 dhe 28 të Statutit të FNK të datës 22 Nëntor 2022, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.01.2023, miratoj rregulloren:

RREGULLORE MBI PËRFAQËSUESËN E NOTIT TË KOSOVËS

KAPITULLI I DISPOZITATAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Përfaqësimi NOTIT të Republikës së Kosovës sipas natyrës së punës dhe motiveve të organizimit të tyre ekziston si rezultat i të arriturave me të larta në sportin e notit. Reprerentacioni e përfaqëson federatën e notit të Kosovës në përgjithësi në garat ndërkombëtare si vijon:

- Gara ndërkombëtare rajonale
- Gara ndërkombëtare kualifikuese për të rinj dhe senior për kampionat Europian, Kampionat Botëror dhe Lojëra olimpikë.

Neni 2

Sigurimi i kushteve për punë dhe i sukseseve të Përfaqësuesve të notit të Kosovës është detyrë e çdo anëtarit të Federatës së notit të Kosovës.

Neni 3

Nën emrin " Përfaqësues i Përfaqësueses shtetërore" mund të jenë pjesë sportistët nga gjitha kategoritë e njohura në Kampionatin shtetëror si të seniorëve/eve, juniorëve/eve, kadetëve, pionerë, dhe fatos/yllka varësisht kompeticionit që marrin pjesë.

Neni 4

Reprerentacionin e përbejnë sportistët (reprerentuesit në tekstin e mëtejme) si dhe anëtarët e Shtabit teknik. Anëtarët e Shtabit profesional- teknik të Përfaqësueses së Kosovës janë: Selektori, trajneri kryesor, dhe trajnerët ndihmës, opsionale janë mjeku dhe fizioterapeuti.

Neni 5

Para garave të Kampionateve Evropiane dhe Botërore, Lojërave Olimpikë apo garave kualifikuese për këtë nivel garues, Selektori në bashkëpunim me Komisionin Profesional të FNK, harton listën e gjere të përfaqësueses dhe shtabit teknik dhe dërgon në Bord Ekzekutiv për miratim. Lista e sportistëve propozohet me së paku 15-30 dite para çdo afati të paraqitjeve pre-eleminare (afatit të parë për paraqitje) për garat ndërkombëtare të reprerentacioneve.

Neni 6

Bordi i FNK-se miraton numrin e sportistëve dhe shtabit përcjellës duke respektuar rregullat e LEN dhe FINA dhe mundësive financiare që ka FNK për prezantim.

KAPITULLI II KLUBET

Neni 7

Klubet duhet te jene anëtare të FNK me të drejta të plota, dhe të jenë ne Listën e klubeve të licencuara nga Komisioni për Vlerësimin e Federatave dhe Licencim të Sportistëve pranë MKRS.

Neni 8

Sportistët e përfaqësueses së Kosovës në Not duhet të jenë anëtarë të klubeve sipas nenit 7.

Neni 9

Klubet nga radhët e cilëve behet përzgjedhja e sportistëve nga ana e selektorit duhet vene ne dispozicion sportistët e tyre ne te gjitha fazat e përgatitjeve dhe paraqitjeve te garave te reprezentacionit

Neni 10

Ftesa për reprezentacion nuk mund te refuzohet nga sportisti apo klubi, përjashtimisht arsyetimit për raste te veçanta si sëmundja e rende ose vdekja e familjareve. Për shkak te mungesës te paarsyeshme te përzgjedhurit ne aktivitetet e reprezentacionit, klubi apo sportisti, u nënshtrohen përgjegjësive konform dispozitave te rregullores disiplinore te FNK-se, qe nënkupton pezullim momental ne paraqitje në garë dhe ngritje te procedurës disiplinore.

Neni 11

Klubi sportistët e te cilit garojnë për reprezentacion, ka te drejte e paraqes kërkesë për shtyrjen e garave qe organizohen nga FNK.

Neni 12

Ne rast te ndërrimit te klubit, sportistët duhet te kenë pëlqimin e klubit paraprak ne forme te shkruar ne FNK.

Neni 13

Periudha kalimtare për ndërrimin e klubit është përcaktuar ne dy afate:

Afati i pare: 1-15 Janar

Afati i dyte: 15 dite pas Kampionatit Shtetëror te RKS ne not.

Neni 14

Sportistët e përfaqësueses dhe klubet e tyre duhet te jene ne harmoni te plote me rregullat e FINA dhe LEN e ne veçanti me rregullat e WADA për anti-doping.

KAPITULLI III SPORTISTET

Neni 15

Sportisti anëtar i Reprerentacionit të Kosovës – është sportisti i cili është pjesë e Reprerentacionit të Kosovës në Not, në gara ndërkombëtare. Është sportist i dalluar, i cili duhet të prezantojë Republikën e Kosovës me dinjitet dhe krenari. Sjelljet e tij duhet të jenë shembull për të tjerët, si në arenën sportive ashtu edhe jashtë saj.

Neni 16

Sportisti i përfaqësueses së Kosovës duhet patjetër të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, me pasaportë valide (me afat zyrtar).

Neni 17

Përzgjedhja e Reprerentuesit të FNK dhe e drejta e tij për të garuar duhet të jetë në harmoni të plotë me rregullat ndërkombëtare FINA dhe LEN.

Neni 18

Sportisti i cili paraprakisht ka poseduar shtetësi të një vendi tjetër, para përfaqësimit të parë të RKS duhet të jetë rezidentë në RKS për një (1) vit dhe nuk duhet të jetë në kundërshtim me rregullat FINA dhe LEN.

Neni 19

Sportisti për paraqitje në gara të nivelit të lartë si Lojëra Olimpikë, Kampionate Botërore dhe Europiane, gëzon të drejtën e mbështetjes financiare për përgatitje adekuate dhe realizim të programit të trajnimit.

Neni 20

Sportisti ftesën për përfaqësim e pranon nga Selektori dhe është i obliguar që të i përgjigjet ftesës me përjashtim të rasteve kur është e pamundur që të jetë pjesë e reprerentacionit.

Neni 21

Sportistët janë të obliguar që gjatë përgatitjeve apo garave të përmbushin udhëzimet e Trajnerit, sipas plan programit të përgatitur nga selektori dhe trajnerët i reprerentacionit.

Neni 22

Sportisti me më së shumti FINA PIKË e tërheqë trajnerin e tij si Trajner i Reprerentacionit dhe duhet të ketë miratimin e Bordit Ekzekutiv të FNK.

Neni 23

Sportistët në rast të pakënaqësive eventuale, kundërshtimeve rreth përbërjes së Reprerentacionit apo mos-përfshirjen së tyre në listën e përfaqësueses së Kosovës, ankesat e tyre janë të obliguar të i adresojnë përmes klubit të tyre ku janë të anëtarësuar për në organet e FNK.

Neni 24

Sportisti/reprezentuesi në rast të mosmarrëveshjes eventuale në klub apo Federatë, mund t'iu adresohet organeve të FNK, në pajtueshmëri me statutin e FNK, Kreu XI, juridiksionin e Republikës së Kosovës si dhe rregullat FINA dhe LEN

KAPITULLI IV SELEKTORI

Neni 25

Bazuar në nenin 12, paragrafi 3 të Statutit të FNK, posti i selektorit është i një rëndësie të veçantë, për shkak të propozimeve që i dërgon në Bordin Ekzekutiv për sportistët të cilët do të jenë pjesë e reprezentacionit të Kosovës.

Neni 26

Selektori i reprezentacionit është anëtar i Këshillit profesional të FNK, person i kualifikuar profesionalisht dhe i aftë që të udhëheqë punën profesionale të reprezentacionit.

Neni 27

Selektori i reprezentacionit zgjidhet nga Bordi Ekzekutiv i FNK, me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit Ekzekutiv dhe i përgjigjet Bordit Ekzekutiv për punën e tij.

Neni 28

Selektori emërohet në parim në kohëzgjatje prej 1 (një) - 4 (katër) viteve - një cikël olimpik. Pas skadimit të mandatit selektori - trajneri kryesor mundet prapë të rizgjidhet në këtë post.

Neni 29

Selektor mund të zgjedhet personi i cili përveç kushteve të parapara me ligj i plotëson edhe këto kushte:

- ka thirrjen e trajnerit të NOTIT
- ka rezultate të theksuara në punën profesionale dhe edukative në klubet elite
- ka përgatitje për të përfaqësuar dhe zhvilluar sportin
- posedon rezultate të theksuara si trajner apo ish sportist

Neni 30

Selektori mund të shkarkohet nga detyra edhe para skadimit të mandatit, nëse:

- nuk plotësohet plan programi i punës dhe për këtë shkak mungojnë rezultatet e reprezentacionit,
- me veprimet e tij e ulë renotën e NOTIT e në veçanti atë të Kosovës
- për shkaqe të parapara me ligj ose me marrëveshje të kontraktuar.

Neni 31

Nese Selektori-trajneri kryesor jep dorëheqje apo i pushon obligimet nga ndonje arsye tjetër, Bordi Ekzekutiv i FNK-së me propozim të Këshillit profesional emerion Ushtruesin e detyres së selektorit deri në zgjedhjen e trajnerit kryesor-selektorit të ri.

Neni 32

Selektori i reprezentacionit në bashkëpunim me Këshillin Profesional, përcakton reprezentacionin sipas nivelit të garave dhe sipas grupmoshave dhe kritereve të përcaktuara nga organizatori i garës.

Neni 33

Për përzgjedhjen e reprezentacionit, selektori dhe Këshilli Profesional janë të pavarur me rastin e përzgjedhjes, mirëpo duke respektuar kriteret bazike të vlerësimit:

- FINA PIKËT- Duke përdorur publikimet zyrtare ndërkombëtare (www.swimrankings.net) dhe databazën e FNK për informacione rreth sportistëve dhe rezultateve të tyre
- Pjesëmarrja në kampionatin shtetëror të Republikës së Kosovës si aktivitet kryesor garues i organizuar nga FNK në Republikën e Kosovës.

Neni 34

Përgjegjësit dhe detyrat e selektorit:

- Në bashkëpunim me Këshillin profesional e harton listën e sportistëve potencial për pjesëmarrje në aktivitetet garuese ndërkombëtare, sipas kalendarit të FNK.
- Në bashkëpunim me Këshillin profesional harton listën e sportistëve për pjesëmarrje në kampet stërvitore.
- Promovimi i kulturës së punës së mirë tek trajneri kryesor dhe ata ndihmës të përfaqësueses
- Realizimi i përgjegjësive udhëheqëse tek grupi i trajnerëve ndihmës dhe atletët me përgjegjshmëri dhe etikë të lartë.
- Në bashkëpunim me këshillin profesional, realizon analiza të performancës së atletëve dhe harton strategji për rritje të performancës dhe rezultateve nga atletët. Këto strategji i rekomandon që të zbatohen nga klubet, anëtarë në të cilin është atleti.
- Në bashkëpunim me këshillin profesional, i rekomandon Bordit Ekzekutiv strategji përmirësuese të menaxhimit të përfaqësueses.
- Për pjesëmarrjen në secilin aktivitet garues, obligohet që të hartoj raportin pas-veprues rreth ecurisë së aktivitetit, performancës dhe të ia dërgoj strukturave udhëheqëse të FNK më së largu 10 ditë pas aktivitetit.

KAPITULLI V TRAJNERI I PËRFAQËSUESES

Neni 35

Trajneri i përfaqësueses është person profesionalisht i kualifikuar dhe i aftë për të udhëhequr me punën profesionale të fushës së trajnimit/stërvitjes për reprezentacionin.

Neni 36

Kriteri kryesor për përzdhedhjen e trajnerit është puna profesionale me sportistë dhe rezultatet e arritura të shprehura në FINA PIKË. Kjo përcakton garat e nivelit të lartë ku ka pjesëmarrës sportistë me rezultatet më të mira në shprehura në FINA PIKË.

Neni 37

Trajneri i përfaqësueses emërohet nga Bordi Ekzekutiv i FNK sipas propozimi të Këshillit Profesional të FNK-së.

Neni 38

Trajneri i përfaqësueses emërohet në parim në kohëzgjatje prej 1 (një) - 4 (katër) viteve - një cikël olimpike. Pas skadimit të mandatit trajneri mundet prapë të rizgjidhet në këtë post.

Neni 39

Detyrat dhe përgjegjësitë e trajnerit:

- Trajneri në koordinim me selektorin e përfaqësueses së Kosovës për të hartuar dhe realizuar planin e stërvitjes së atletëve për garën në të cilën do të marr pjesë reprezentacioni.
- Në bashkëpunim me selektorin dhe Këshillin Profesional harton planet e stërvitjes së përfaqësueses për kampet sportive dhe drejton implementimin e atij plani nga trajnerët pjesëmarrës në atë kamp.
- Asiston selektorin në realizimin e analizave të performancës së atletëve dhe hartimin e strategjive për rritje të performancës dhe rezultateve nga atletët.
- Ndihmon selektorin në hartimin e raportit pas-veprues rreth ecures së aktivitetit, performancës dhe të ia dërgoj strukturave udhëheqëse të FNK më së largu 10 ditë pas aktivitetit.

Neni 40

Trajneri obligohet që sportistët e përfaqësueses të i edukoj për respektimin e Rregullave Anti-Doping konform WADA (World Anti-Doping Association), në mënyrë që të zbatohen ato rregulla në përpikëri nga të gjithë sportistët anëtarë të reprezentacionit.

Neni 41

Trajneri obligohet që sportistët të respektojnë Statutin e FNK si dhe rregullat FINA dhe LEN gjatë gjithë aktiviteteve garuese, si ato vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare.

KAPITULLI VI
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 42

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet “Rregullore Mbi Përfaqësueset e Notit të Kosovës” e datës 04.07.2023.

Neni 43

Interpretimin e kësaj rregullore e bënë Bordi Ekzekutiv i FNK-së, i cili gjithashtu ka mandatin sipas Statutit të FNK-së për të bërë ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje.

Neni 44

Kjo rregullore hynë në fuqi, ditën e aprovimit nga Bordi Ekzekutiv i FNK-së.

Prishtinë, datë 07.01.2023

